4. Fitimet që burojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të krahasueshëm, të tilla si interesat në një ortakëri ose besim, mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues nëse, në çdo kohe përgjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këto aksione ose interesa të krahasueshëm kanë gjeneruar më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre



drejtpërdrejt ose tërthorazi nga prona e paluajtshme (prona e vërtetë), siç përcaktohet në Nenin 6, të vendosur në atë Shtet tjetër Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone, përveç asaj të referuar në paragrafët 1, 2, 3, dhe 4, janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin tjetërsuesi është rezident.

Neni 14

SHËRBIMET E PAVARURA PERSONALE

1. Të ardhurat e krijuara nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitete të tjera me karakter të pavarur do të tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues. Sidoqoftë, të ardhura të tilla mund të tatohen edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse të disponueshme rregullisht në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së aktiviteteve; në atë rast, vetëm ajo shumë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë Shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që arrijnë ose tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal në fjalë; në atë rast, vetëm aq shumë e të ardhurave që rrjedhin nga aktivitetet e kryera në atë Shtet tjetër mund të tatohen në atë Shtet.

2. Shprehja “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitete të pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose mësimore, si dhe aktivitete të pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

Neni 15

TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI

1. Në varësi të dispozitave të neneve 16, 18 dhe 19, pagat, shtesat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që burojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim do të tatohen vetëm në atë Shtet përveç nëse punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë shpërblimi i tillë që buron prej tij mund të tatohet në atë Shtet tjetër.


2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet që burojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në Shtetin e parë të përmendur nëse:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në vitin përkatës fiskal, dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër, dhe

c) shpërblimi nuk bartet nga një njësi e përhershme ose një bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, shpërblimi i marrë nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim, si një anëtar i komplementit të rregullt të një anijeje ose aeroplani, që ushtrohet në bordin e një anijeje ose aeroplani që operon në trafikun



ndërkombëtar, përveç se në bordin e një anijeje ose aeroplani që operon vetëm brenda Shtetit tjetër Kontraktues, do të tatohet vetëm në Shtetin e përmendur së pari.

4. Pagesat e marra për shkak të punësimit në një Shtet Kontraktues si pagesa e shkëputjes ose shuma e ngjashme paushallë në lidhje me atë punësim do të tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

Neni 16

TARIFAT E DREJTORËVE

Tarifat e drejtorëve dhe pagesat tjera të ngjashme që burojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij/saj si anëtar i bordit të drejtorëve ose ndonjë organi tjetër të ngjashëm i një kompanie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

Neni 17

ARTISTËT DHE SPORTISTËT

1. Pavarësisht dispozitave të neneve 14 dhe 15, të ardhurat që burojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, në teatër, film, kinema, në radio ose televizion, artist apo një muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet personale të atij rezidenti si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në cilësinë e tij/saj nuk i takojnë vet artistit apo sportistit, por një personi tjetër, ato të ardhura mund, pavarësisht dispozitave të neneve 7, 14 dhe 15, të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen për të ardhurat që burojnë nga aktivitetet e kryera në një Shtet Kontraktues nga artistë apo sportistë nëse vizita në atë Shtet mbështetet tërësisht ose kryesisht nga fondet publike të Shtetit tjetër ose nënndarjet politike ose autoritetet lokale të tij, ose nga një institucion i cili njihet si një institucion jofitimprurës, ose nëse aktivitete të tilla kryhen në Shtetin tjetër sipas një plani të shkëmbimit kulturor midis qeverive të të dy Shteteve Kontraktuese. Në një rast të tillë, të ardhurat tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin personi është rezident.

Neni 18


PENSIONET

Në varësi të dispozitave të paragrafit 2 të Nenit 19, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet.

Neni 19

SHËRBIMI I QEVERISË

1. (a) Pagat, shtesat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike apo një autoritet lokal i tij ndaj një individi në lidhje me



shërbimet e ofruara në atë Shtet apo nënndarje ose autoritet, do të tatohen vetëm në atë Shtet.

(b) Sidoqoftë, pagat, shtesat dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet kryhen në atë Shtet dhe individit është një rezident i atij Shteti i cili :

(i) është shtetas i atij shteti; ose

(ii) nuk është bërë rezident i atij Shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimeve.

2. (a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara nga, ose jashtë fondeve të krijuara nga; një Shtet Kontraktues, nënndarje politike apo një autoritet lokal i tij/saj një individit në lidhje me shërbimet e kryera në atë Shtet, nënndarje politike ose autoritet, do të tatohen vetëm në atë shtet.

(b) Sidoqoftë, pensionet e tilla dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individit është rezident, dhe shtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për pagat, shtesat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, sa i përket shërbimeve të kryera në lidhje me një biznes të udhëhequr nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike ose një autoritet lokal i tij/saj.

Neni 20

STUDENTËT

1. Pagesat që një student, një praktikant biznesi ose një praktikant i cili është ose ishte menjëherë para se të vizitonte një Shtet Kontraktues një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe i cili është i pranishëm në Shtetin e parë të përmendur vetëm për qëllimin e arsimimit ose trajnimit të tij/saj për qëllime të mirëmbajtjes, arsimimit ose trajnimit të tij/saj nuk do të tatohet në atë Shtet, me kusht që pagesa të tilla të vijnë nga burime jashtë këtij Shteti.

2. Përfitimet e këtij neni zgjasin vetëm për një periudhë që nuk i kalon gjashtë vitet rresht nga data e mbërritjes së tij/saj në Shtetin e parë të përmendur.

Neni 21

TË ARDHURAT TJERA

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që burojnë, që nuk trajtohen në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, do të tatohen vetëm në atë Shtet .

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen për të ardhurat, përveç të ardhurave nga pasuria e paluajtshme siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse pranuesi i të ardhurave të tilla, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në një Shtet tjetër kontraktues përmes një njësie të përhershme të vendosur në atë Shtet, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në atë Shtet, dhe e drejta ose prona për të cilën paguhet të ardhurat lidhen në mënyrë efektive me një njësi të tillë të përhershme ose bazë fikse. Në një rast të tillë do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, sipas rastit.



*Kapitulli IV***METODAT PËR ELIMINIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË****Neni 22****ELIMINIMI I TATIMIT TË DYFISHTË**

1. Në rastin e Italisë, tatimi i dyfishtë do të eliminohet si më poshtë:

banorët e Italisë që nxjerrin zëra të të ardhurave të cilat, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të taten në Kosovë, mund të përfshijnë zëra të tillë të të ardhurave në bazën tatimore pas së cilës vendosen tatimet në Itali, varësisht nga dispozitat e zbatueshme të ligjit Italian.

Në varësi të dispozitave të zbatueshme të ligjit Italian, Italia do të lejojë si zbritje nga tatimi i llogaritur kështu nga tatimet e të ardhurave të paguara në Kosovë, por zbritja nuk duhet të kalojë proporcionin e tatimit Italian që i atribuohet zërave të tillë të të ardhurave që këto zëra bartin për të ardhurat e plota.

2. Në rastin e Kosovës, tatimi i dyfishtë do të eliminohet si më poshtë:

kur një rezident i Kosovës siguron të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të taten në Itali, Kosova do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguar në Itali. Sidoqoftë, një zbritje e tillë nuk duhet të tejkalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat e Kosovës, siç është llogaritur para se të jepet zbritja, e cila i atribuohet të ardhurave që mund të taten në Itali.

3. Kur, në përputhje me ndonjë dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e krijuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues janë të përjashtuara nga tatimi në atë Shtet, ai Shtet megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të një rezidenti të tillë, mund të marrë parasysh të ardhurat e liruara.

*Kapitulli V***DISPOTITAT E VEÇANTA****Neni 23****JO-DISKRIMINIMI**

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen ndonjë tatimi ose kërkesë në Shtetin tjetër Kontraktues të ndërlidhur, e cila është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të cilët shtetasit e atij Shteti janë ose mund ti nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e Nenit 1, do të zbatohet gjithashtu për personat që nuk janë rezidentë të njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi mbi një njësi të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të vendoset në mënyrë pak më të favorshme në atë Shtet tjetër sesa tatimi i marrë mbi ndërmarrjet e atij Shteti tjetër që kryejnë të njëjtat veprimtari. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet sikur detyron një Shtet Kontraktues t'u japë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndonjë mëditje personale, lirim dhe zbritje për qëllime të tatimit për shkak të statusit civil ose përgjegjësiwe familjare që u jep banorëve të vet.



3. Me përjashtim të rastit kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11, ose paragrafit 6 të nenit 12, interesi, të drejtat pronësore dhe disbursimet e tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues do të zbriten, me qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të një ndërmarrjeje të tillë, në të njëjtat kushte sikur të ishin paguar një rezidenti të Shtetit të përmendur së pari.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i së cilave është në pronësi të plotë ose pjesërisht ose të kontrolluar, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, nga një ose më shumë rezidentë të një Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do t'i nënshtrohen ndonjë tatimi ose kërkesë në Shtetin e përmendur së pari e cila është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat me të cilat janë ose mund t'i nënshtrohen ndërmarrjet e tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur së pari.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga parashikimet e nenit 2, do të zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi .

Neni 24

PROCEDURA E MARRRËVESHJES SË PËRBASHKËT

1. Kur një person konsideron se veprimet e njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim jo në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ai/ajo mund, pavarësisht nga mjetet juridike të parashikuara nga ligji i brendshëm i atyre Shteteve, të paraqesë çështjen e tij/saj tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues shtetas i të cilit ai/ajo është rezident, ose, nëse rasti i tij/saj bie nën paragrafin 1 të nenit 23, ndaj atij Shteti Kontraktues , shtetas i të cilit është ai/ajo. Rasti duhet të paraqitet brenda tre (3) vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim jo në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent do të përpiqet, nëse kundërshtimi duket se është i justifikuar dhe nëse nuk është në gjendje të arrijë një zgjidhje të kënaqshme, për të zgjidhur çështjen me marrëveshje të ndërsjellë me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, që ka për qëllim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht kufizimit kohor sipas ligjit të brendshëm të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që del për sa i përket interpretimit ose zbatimit të Marrëveshjes. Ata gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk parashikohen në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin drejtpërdrejtë, duke përfshirë përmes një komisioni të përbashkët të përbërë nga ata ose përfaqësuesit e tyre, me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

5. Ku,

a) sipas paragrafit 1, një person ka paraqitur një rast tek autoriteti kompetent i një Shteti Kontraktues mbi bazën që veprimet e njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese kanë rezultuar për atë person në tatim jo në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dhe

b) autoritetet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur atë çështje në përputhje me paragrafin 2 brenda dy viteve nga data kur të gjithë informacioni i kërkuar nga autoritetet kompetente për të adresuar çështjen iu është dhënë të dy autoriteteve kompetente,



çdo çështje e pazgjidhur që del nga rasti do të paraqitet në arbitrazh nëse personi e kërkon me shkrim. Këto çështje të pazgjidhura nuk do të, sidoqoftë, dërgohen në arbitrazh nëse një vendim mbi këto çështje është dhënë tashmë nga një gjykatë ose gjykatë administrative e cilitdo Shtet. Përveç nëse një person i prekur drejtpërdrejtë nga rasti nuk pranon marrëveshjen e përbashkët që zbaton vendimin e arbitrazhit, ai vendim do të jetë i detyrueshëm për të dy Shtetet Kontraktuese dhe do të zbatohet pavarësisht nga çdo kufizim kohor në ligjet e brendshme të këtyre shteteve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me marrëveshje të përbashkët mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi.

Neni 25

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacione të tilla që janë të parashikueshme dhe relevante për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese, të nënndarjeve të tyre politike apo të autoriteteve të tyre lokale, për aq sa tatimi mbi të nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk është i kufizuar me nenin 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë sikurse informacioni i marrë sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti dhe do t'u zbulohet vetëm personave ose autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që kanë të bëjnë me vlerësimin ose mbledhjen, ekzekutimin ose ndjekjen penale në lidhje me përcaktimin e ankesave në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen e mësipërme. Personat ose autoritetet e tilla do ta përdorin informacionin vetëm për qëllime të tilla. Ata mund të zbulojnë informacionin në procedurat gjyqësore publike ose në vendimet gjyqësore. Pavarësisht nga sa u tha më lart, informacioni i marrë nga një Shtet Kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera kur një informacion i tillë mund të përdoret për qëllime të tilla të tjera sipas ligjeve të të dyja Shteteve dhe autoritetit kompetent të Shtetit furnizues që autorizon një përdorim të tillë.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të interpretohen në mënyrë që t'i imponojnë një Shtet Kontraktues detyrimin:

a) të ndërmarrë masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën e tij administrative ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të ofrojë informacion që nuk është i arritshëm sipas ligjeve ose gjatë rrjedhës normale të administrimit të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues ;

c) të ofrojë informacion që mund të zbulojë ndonjë sekret tregtar, biznesi, industrial, komercial ose profesional ose proces tregtar, ose informacion, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (*rendin publik*) .

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të përdorë masat e tij/saj të mbledhjes së informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, edhe pse ai Shtet tjetër mund të mos ketë nevojë për një informacion të tillë për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që është i përfshirë në fjalinë paraardhëse u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast kufizimet e tilla nuk do të interpretohen për të lejuar një Shtet Kontraktues të refuzojë të sigurojë informacion vetëm sepse nuk ka interes të brendshëm në një informacion të tillë.



5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk mund të interpretohen për të lejuar një Shtet Kontraktues të refuzojë të japë informacion vetëm sepse informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i caktuar ose person që vepron në një agjenci ose një kapacitet fiduciar, ose për shkak se ka të bëjë me interesat e pronësisë në një person.

Neni 26

NDIHMA NË MBLEDHJEN E TATIMEVE

1. Shtetet Kontraktuese do t'i japin ndihmë njëri-tjetrës në mbledhjen e kërkesave për të ardhura. Kjo ndihmë nuk është e kufizuar nga nenet 1 dhe 2. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të vendosin me marrëveshje të përbashkët mënyrën e zbatimit të këtij neni.

2. Shprehja "kërkesë për të ardhura" siç përdoret në këtë nen do të thotë një shumë që i detyrohet tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi të vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese nënndarjeve të tyre politike ose të autoriteteve të tyre lokale, për aq sa tatimi mbi të nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje ose ndonjë instrument tjetër në të cilin Shtetet Kontraktuese janë palë, duke përfshirë edhe interesin, gjobat administrative dhe kostot e mbledhjes ose ruajtjes në lidhje me një shumë të tillë.

3. Kur një kërkesë për të hyrat e një Shteti Kontraktues është e zbatueshme sipas ligjeve të atij Shteti dhe i detyrohet një personi i cili, në atë kohë, nuk mundet, sipas ligjeve të atij Shteti, të parandalojë mbledhjen e tyre, ajo kërkesë për të hyra me kërkesë të autoritetit kompetent të atij Shteti, mund të pranohet për qëllime të mbledhjes nga autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues. Kjo kërkesë për të hyra do të mbledhet nga ai Shtet tjetër në përputhje me dispozitat e ligjeve të tij të zbatueshme për zbatimin dhe mbledhjen e tatimeve të tij sikur kërkesa për të hyra të ishte një kërkesë për të hyrat e atij Shteti tjetër.

4. Kur një kërkesë për të hyrat e një Shteti Kontraktues është një kërkesë në lidhje me të cilën ai Shtet, sipas ligjit të tij, mund të ndërmarrë masa ruajtjeje me qëllim që të sigurojë mbledhjen e tij/saj, ajo kërkesë për të hyra, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij Shteti, të pranohet për qëllime të marrjes së masave të ruajtjes nga autoriteti kompetent i Shtetit tjetër kontraktues. Shteti tjetër do të ndërmarrë masa të ruajtjes në lidhje me atë kërkesë për të hyra në përputhje me dispozitat e ligjeve të tij sikur kërkesa për të hyra të ishte një kërkesë për të hyra të atij shteti tjetër edhe nëse, në kohën kur zbatohen këto masa, kërkesa për të hyra nuk është e zbatueshme në shtetin e përmendur së pari ose i detyrohet një personi që ka të drejtë të parandalojë mbledhjen e tij/saj.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4, një kërkesë për të hyra e pranuar nga një Shtet Kontraktues për qëllimet e paragrafit 3 ose 4, në atë Shtet nuk do t'i nënshtrohet afateve kohore apo do t'i akordohet ndonjë përparësi e zbatueshme për një kërkesë të të hyrave sipas ligjit të atij Shteti për shkak të natyrës së tij/saj. Për më tepër, një kërkesë për hyra e pranuar nga një Shtet Kontraktues për qëllimet e paragrafit 3 ose 4 nuk do të ketë, në atë Shtet, ndonjë përparësi të zbatueshme për atë kërkesë të të hyrave sipas ligjeve të Shtetit tjetër Kontraktues.

6. Procedurat në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose shumën e një kërkesë për të hyrat e një Shteti Kontraktues nuk do të paraqiten para gjykatave ose organeve administrative të Shtetit tjetër Kontraktues.

7. Në rastet kur pas paraqitjes së një kërkesë nga një Shtet Kontraktues sipas paragrafit 3 ose 4 dhe para se Shteti tjetër Kontraktues të ketë mbledhur dhe dërguar kërkesën përkatëse të të hyrave të Shteti i përmendur së pari, pretendimi përkatës i të hyrave pushon të jetë



- a) në rastin e një kërkesë sipas paragrafit 3, një kërkesë për të hyrat e Shtetit të përmendur së pari që është i zbatueshëm sipas ligjeve të këtij Shteti dhe i detyrohet një personi i cili, në atë kohë, nuk mundet, sipas ligjeve të atij Shteti, të parandalojë mbledhjen e tij, ose
- b) në rastin e një kërkesë sipas paragrafit 4, një kërkesë për të hyrat e Shtetit të përmendur së pari për të cilin ai Shtet, sipas ligjeve të tij, mund të ndërmarrë masa të ruajtjes me qëllim që të sigurojë mbledhjen e tij/saj

autoriteti kompetent i Shtetit të përmendur së pari do të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent të Shtetit tjetër për atë fakt dhe sipas opsionit të Shtetit tjetër, Shteti i përmendur së pari ose do të pezullojë ose tërheqë kërkesën e tij/saj.

8. Në asnjë rast, dispozitat e këtij neni nuk do të interpretohen në mënyrë që t'i imponojnë një Shteti Kontraktues detyrimin :

- a) të ndërmarrë masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues ;
- b) të ndërmarrë masa që do të ishin në kundërshtim me politikën publike (*rendin publik*);
- c) të ofrojnë ndihmë nëse Shteti tjetër Kontraktues nuk ka ndjekur të gjitha masat e arsyeshme të mbledhjes ose ruajtjes, sipas rastit, të disponueshme sipas ligjeve të tij/saj ose praktikës administrative;
- d) të ofrojnë ndihmë në ato raste kur barra administrative për atë Shtet është qartësisht jo proporcionale me përfitimin që do të merret nga Shteti tjetër Kontraktues .

Neni 27

ANËTARËT E MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE POSTEVE KONSULLORE

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të ndikojë në privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

E DREJTA PËR PËRFITIME

Pavarësisht ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të jepet në lidhje me një zë të ardhurash nëse është e arsyeshme të konkludohet se duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse, se marrja e këtij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të ndonjë marrëveshjeje ose transaksioni që rezultoi drejtpërdrejtë ose tërthorazi në atë përfitim, përveç nëse përcaktohet që dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektivin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.



*Kapitulli VI***DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE****Neni 29****HYRJA NË FUQI**

1. Secili prej Shteteve Kontraktuese do të njoftojë tjetrin, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të brendshme të kërkuara nga ligji për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas pranimit të njoftimit të fundit.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë efekt:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për shumat e paguara ose të kredituara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pasues në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi;

b) në lidhje me tatimet tjera mbi të ardhurat, mbi tatimet që kanë të bëjnë me vitet e tatueshme që fillojnë në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pasues në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi.

3. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje të plotë me detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

Neni 30**NDËRPRERJA**

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa të ndërpritet nga një prej Shteteve Kontraktuese. Secili Shtet Kontraktues mund të ndërpresë Marrëveshjen, përmes kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftim me shkrim të përfundimit të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik pas periudhës prej pesë vjetësh nga data në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi.

2. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për shumat e paguara ose të kredituara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pasues në të cilin është dhënë njoftimi;


b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat, mbi tatimet që kanë të bëjnë me vitet e tatueshme që fillojnë më ose pas janarit të parë të vitit kalendarik pasues në të cilin është dhënë njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të poshtë nënshkruarit, të autorizuar siç duhet aty, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.


Bërë në Pishtin me 22/6/2022 në dy origjinale, secila në gjuhët Italisht, Shqip dhe Anglisht, të gjitha tekstet duke qenë barabartë autentike. Në rast të dallimeve në interpretim apo zbatim, teksti në Anglisht do të mbizotërojë.

Për Qeverinë e

Republikës së Italisë



Për Republikën e Kosovës



PROTOKOLLI I MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR ELEMENIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË SA I PËRKET TATIMEVE NË TË ARDHURA DHE PARANDALIMIT TË EVAZIONIT FISKAL DHE SHMANGIES

Me nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Republikës së Kosovës për eliminimin e tatimit të dyfishtë sa i përket tatimeve mbi të ardhurat dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangies, nënshkruesit kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme do të përbëjnë një pjesë integrale të Marrëveshjes.

A) Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, shprehja “fond i njohur pensional” do të thotë, në rastin e Italisë, një fond pensional i mbikëqyrur nga *Commissione di vigilanza sui fondi pensione - COVIP*, dhe në rastin e Kosovës, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (*Kosovo Pension Savings Trust*) dhe fondet tjera pensionale të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

B) Me referencë ndaj nenit 11 paragrafit 3 (b):

- me referencë ndaj Italisë, shprehja “çdo subjekt publik” do të thotë Cassa Depositi e Prestiti - CDP, Istituto per i servizi assicurativi del commercio estero - SACE, Società italiana per le imprese all'estero - Simest;
- Shtetet Kontraktuese, kur është e nevojshme, do të konsultohen me shpejtësi me njëri-tjetrin për të përfunduar një Protokoll ndryshues për të rishikuar subjektet publike me të drejtë.

C) Duke iu referuar nenit 15 paragrafi 4, kuptohet që pagesa të marra për shkak të punësimit në një Shtet Kontraktues, si pagesa e shkëputjes ose pagesa të tjera të ngjashme paushall në lidhje me atë punësim nuk do të konsiderohen si pensione.

D) Duke iu referuar nenit 18, shprehja “pensione dhe shpërblime të tjera të ngjashme” do të thotë pensione që rrjedhin nga pagesa në konsideratë të punësimit të kaluar dhe shpërblimeve që paguhën në lidhje me shërbimet e mëparshme personale të pavarura, si dhe pagesa nga një fond pensioni ose një skemë pensionale në të cilën individët mund të marrin pjesë në mënyrë që të sigurojnë përfitime pensioni, kur një fond ose skemë e tillë rregullohet në përputhje me ligjet e atij Shteti Kontraktues dhe njihet si e tillë për qëllime tatimore.

E) Me përjashtim të rasteve kur përfitimet e kësaj Marrëveshjeje zbatohen drejtpërdrejtë, tatimet e mbajtura në burim në një Shtet Kontraktues, me kërkesë të tatimpaguesit, do të rimbursohen në masën që e drejta për të mbledhur tatimet është e kufizuar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Kërkesat për rimbursim, të cilat do të bëhen brenda afatit të përcaktuar nga ligji i Shtetit Kontraktues i cili është i detyruar të bëjë rimbursimin, përveç rasteve në të cilat është arritur një marrëveshje sipas Procedurës së Marrëveshjes së Ndërsjellë të parashikuar nga neni 24, do të shoqërohen nga një certifikatë zyrtare e Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit është tatimpaguesi që vërteton ekzistencën e kushteve të kërkuara për të pasur të drejtën e përfitimeve të parashikuara nga Marrëveshja.


Në dëshmi të kësaj, të poshtë nënshkruarit, të autorizuar si rregull nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Prishtine me 22/6/2021, në dy origjinale, secila në gjuhët Italisht, Shqip dhe Anglisht, të gjitha tekstet duke qenë barabartë autentike. Në rast të dallimeve në interpretim apo zbatim, teksti në Anglisht do të mbizotërojë.

Për Qeverinë e

Republikës së Italisë

Për Republikën e Kosovës



CONVENTION
BETWEEN
THE GOVERNMENT OF THE ITALIAN REPUBLIC
AND
THE REPUBLIC OF KOSOVO

FOR THE ELIMINATION OF DOUBLE TAXATION WITH RESPECT TO TAXES ON
INCOME AND THE PREVENTION OF TAX EVASION AND AVOIDANCE

The Government of the Italian Republic and the Republic of Kosovo,

Desiring to further develop their economic relationship and to enhance their co-operation in tax matters,

Intending to conclude a Convention for the elimination of double taxation with respect to taxes on income without creating opportunities for non-taxation or reduced taxation through tax evasion or avoidance (including through treaty-shopping arrangements aimed at obtaining reliefs provided in this Convention for the indirect benefit of residents of third States),

Have agreed as follows:

Chapter I

SCOPE OF THE CONVENTION

Article 1

PERSONS COVERED

1. This Convention shall apply to persons who are residents of one or both of the Contracting States.
2. For the purposes of this Convention, income derived by or through an entity or arrangement that is treated as wholly or partly fiscally transparent under the tax law of either Contracting State shall be considered to be income of a resident of a Contracting State but only to the extent that the income is treated, for purposes of taxation by that State, as the income of a resident of that State.
3. This Convention shall not affect the taxation, by a Contracting State, of its residents except with respect to the benefits granted under paragraph 3 of Article 7, paragraph 2 of Article 9 and Articles 19, 20, 22, 23, 24 and 27.

Article 2

TAXES COVERED

1. This Convention shall apply to taxes on income imposed on behalf of a Contracting State or of its political subdivisions or local authorities, irrespective of the manner in which they are levied.



2. There shall be regarded as taxes on income all taxes imposed on total income or on elements of income, including taxes on gains from the alienation of movable or immovable property, taxes on the total amounts of wages or salaries paid by enterprises.

3. The existing taxes to which the Convention shall apply are in particular:

(a) in Italy:

- (i) the personal income tax (l'imposta sul reddito delle persone fisiche);
- (ii) the corporate income tax (l'imposta sul reddito delle società);
- (iii) the regional tax on productive activities (l'imposta regionale sulle attività produttive);

whether or not they are collected by withholding at source (hereinafter referred to as "Italian Tax");

(b) in Kosovo:

- (i) the personal income tax;
 - (ii) the corporate income tax;
- (hereinafter referred to as "Kosovo Tax").

4. The Convention shall apply also to any identical or substantially similar taxes which are imposed after the date of signature of the Convention in addition to, or in place of, the existing taxes. The competent authorities of the Contracting States shall notify each other of significant changes which have been made in their respective taxation laws.

Chapter II

DEFINITIONS

Article 3

GENERAL DEFINITIONS

1. For the purposes of this Convention, unless the context otherwise requires:

- (a) the term "Italy" means the Italian Republic and includes any area beyond the territorial waters which is designated as an area within which Italy, in compliance with its legislation and in conformity with International Law, may exercise sovereign rights in respect of the exploration and exploitation of the natural resources of the seabed, the subsoil and the superjacent waters;
- (b) the term "Kosovo" means the Republic of Kosovo, namely all the land territory, over which it has jurisdiction or sovereign rights for the purpose of exploration, exploitation and conservation of natural resources pursuant to international law;
- (c) the terms "a Contracting State" and "the other Contracting State" mean Kosovo or Italy as the context requires;
- (d) the term "person" includes an individual, a company and any other body of persons;
- (e) the term "company" means any body corporate or any entity that is treated as a body corporate for tax purposes;



- (f) the terms "enterprise of a Contracting State" and "enterprise of the other Contracting State" mean respectively an enterprise carried on by a resident of a Contracting State and an enterprise carried on by a resident of the other Contracting State;
- (g) the term "international traffic" means any transport by a ship or aircraft except when the ship or aircraft is operated solely between places in a Contracting State and the enterprise that operates the ship or aircraft is not an enterprise of that State;
- (h) the term "competent authority" means:
 - (i) in the case of Italy, the Ministry of Economy and Finance or its authorized representatives,
 - and
 - (ii) in the case of Kosovo, the Ministry of Finance or its authorized representatives.
- (i) the term "national", in relation to a Contracting State means:
 - (i) any individual possessing the nationality of a Contracting State;
 - (ii) any legal person, partnership or association deriving its status as such from the laws in force in a Contracting State.
- (j) the term "recognized pension fund" of a State means an entity or arrangement established in that State that is treated as a separate person under the taxation laws of that State and:
 - (i) that is established and operated exclusively or almost exclusively to administer or provide retirement benefits and ancillary or incidental benefits to individuals and that is regulated as such by that State or one of its political subdivisions or local authority or
 - (ii) that is established and operated exclusively or almost exclusively to invest funds for the benefit of entities or arrangements referred to in subparagraph (i).

2. As regards the application of the Convention at any time by a Contracting State, any term not defined therein shall, unless the context otherwise requires, have the meaning that it has at that time under the law of that State for the purposes of the taxes to which the Convention applies, any meaning under the applicable tax laws of that State prevailing over a meaning given to the term under other laws of that State.

Article 4

RESIDENT

1. For the purposes of this Convention, the term "resident of a Contracting State" means any person who, under the laws of that State, is liable to tax therein by reason of his domicile, residence, place of incorporation, place of management or any other criterion of a similar nature and also includes that State and any political subdivision or local authority thereof as well as a recognized pension fund of that State. This term, however, does not include any person who is liable to tax in that State in respect only of income from sources in that State.
2. Where by reason of the provisions of paragraph 1 an individual is a resident of both Contracting States, then his status shall be determined as follows:
 - (a) he shall be deemed to be a resident only of the State in which he has a permanent home available to him; if he has a permanent home available to him in both States, he shall be



deemed to be a resident only of the State with which his personal and economic relations are closer (centre of vital interests);

(b) if the State in which he has his centre of vital interests cannot be determined, or if he does not have a permanent home available to him in either State, he shall be deemed to be a resident only of the State in which he has an habitual abode;

(c) if he has an habitual abode in both States or in neither of them, he shall be deemed to be a resident only of the State of which he is a national;

(d) if he is a national of both States or neither of them, the competent authorities of the Contracting States shall settle the question by mutual agreement.

3. Where by reason of the provisions of paragraph 1 a person other than an individual is a resident of both Contracting States, the competent authorities of the Contracting States shall endeavor to determine by mutual agreement the Contracting State of which such person shall be deemed to be a resident for the purposes of the Convention, having regard to its place of effective management, the place where it is incorporated or otherwise constituted and any other relevant factors. In the absence of such agreement, such person shall not be entitled to any relief or exemption from tax provided by this Convention except to the extent and in such manner as may be agreed upon by the competent authorities of the Contracting States.

Article 5

PERMANENT ESTABLISHMENT

1. For the purposes of this Convention, the term "permanent establishment" means a fixed place of business through which the business of an enterprise is wholly or partly carried on.

2. The term "permanent establishment" includes especially:

- (a) a place of management;
- (b) a branch;
- (c) an office;
- (d) a factory;
- (e) a workshop; and
- (f) a mine, an oil or gas well; a quarry or any other place of extraction of natural resources.

3. A building site or construction or installation project constitutes a permanent establishment only if it lasts more than 12 months.

4. Notwithstanding the preceding provisions of this Article, the term "permanent establishment" shall be deemed not to include:

- (a) the use of facilities solely for the purpose of storage, display or delivery of goods or merchandise belonging to the enterprise;
- (b) the maintenance of a stock of goods or merchandise belonging to the enterprise solely for the purpose of storage, display or delivery;
- (c) the maintenance of a stock of goods or merchandise belonging to the enterprise solely for the purpose of processing by another enterprise;



- (d) the maintenance of a fixed place of business solely for the purpose of purchasing goods or merchandise or of collecting information, for the enterprise;
- (e) the maintenance of a fixed place of business solely for the purpose of carrying on, for the enterprise, any other activity;
- f) the maintenance of a fixed place of business solely for any combination of activities mentioned in subparagraphs (a) to (e),

provided that such activity or, in the case of subparagraph f), the overall activity of the fixed place of business, is of a preparatory or auxiliary character.

4.1 Paragraph 4 shall not apply to a fixed place of business that is used or maintained by an enterprise if the same enterprise or a closely related enterprise carries on business activities at the same place or at another place in the same Contracting State and

- (a) that place or other place constitutes a permanent establishment for the enterprise or the closely related enterprise under the provisions of this Article, or
- (b) the overall activity resulting from the combination of the activities carried on by the two enterprises at the same place, or by the same enterprise or closely related enterprises at the two places, is not of a preparatory or auxiliary character,

provided that the business activities carried on by the two enterprises at the same place, or by the same enterprise or closely related enterprises at the two places, constitute complementary functions that are part of a cohesive business operation.

5. Notwithstanding the provisions of paragraphs 1 and 2 but subject to the provisions of paragraph 6, where a person is acting in a Contracting State on behalf of an enterprise and, in doing so, habitually concludes contracts, or habitually plays the principal role leading to the conclusion of contracts that are routinely concluded without material modification by the enterprise, and these contracts are:

- (a) in the name of the enterprise; or
- (b) for the transfer of the ownership of, or for the granting of the right to use, property owned by that enterprise or that the enterprise has the right to use; or
- (c) for the provision of services by that enterprise,

that enterprise shall be deemed to have a permanent establishment in that Contracting State in respect of any activities which that person undertakes for the enterprise, unless the activities of such person are limited to those mentioned in paragraph 4 which, if exercised through a fixed place of business (other than a fixed place of business to which paragraph 4.1 would apply), would not make this fixed place of business a permanent establishment under the provisions of that paragraph.

6. Paragraph 5 shall not apply where the person acting in a Contracting State on behalf of an enterprise of the other Contracting State carries on business in the first-mentioned Contracting State as an independent agent and acts for the enterprise in the ordinary course of that business. Where, however, a person acts exclusively or almost exclusively on behalf of one or more enterprises to which it is closely related, that person shall not be considered to be an independent agent within the meaning of this paragraph with respect to any such enterprise.

7. The fact that a company which is a resident of a Contracting State controls or is controlled by a company which is a resident of the other Contracting State, or which carries on business



in that other State (whether through a permanent establishment or otherwise), shall not of itself constitute either company a permanent establishment of the other.

8. For the purposes of this Article a person or enterprise is closely related to an enterprise if, based on all the relevant facts and circumstances, one has control of the other or both are under the control of the same persons or enterprises. In any case, a person or enterprise shall be considered to be closely related to an enterprise if one possesses directly or indirectly more than 50 per cent of the beneficial interest in the other (or, in the case of a company, more than 50 per cent of the aggregate vote and value of the company's shares or the beneficial equity interest in the company) or if another person or enterprise possesses directly or indirectly more than 50 per cent of the beneficial interest (or, in the case of a company, more than 50 per cent of the aggregate vote and value of the company's shares or the beneficial equity interest in the company) in the person and the enterprise.

Chapter III

TAXATION OF INCOME

Article 6


INCOME FROM IMMOVABLE PROPERTY

1. Income derived by a resident of a Contracting State from immovable property (including income from agriculture or forestry) situated in the other Contracting State may be taxed in that other State.
2. The term "immovable property" shall have the meaning which it has under the law of the Contracting State in which the property in question is situated. The term shall in any case include property accessory to immovable property, livestock and equipment used in agriculture and forestry, rights to which the provisions of general law respecting landed property apply, usufruct of immovable property and rights to variable or fixed payments as consideration for the working of, or the right to work, mineral deposits, sources and other natural resources; ships, boats and aircraft shall not be regarded as immovable property.
3. The provisions of paragraph 1 shall apply to income derived from the direct use, letting, or use in any other form of immovable property.
4. The provisions of paragraphs 1 and 3 shall also apply to the income from immovable property of an enterprise and to the income from immovable property used for the performance of independent personal services.

ARTICLE 7

BUSINESS PROFITS

1. Profits of an enterprise of a Contracting State shall be taxable only in that State unless the enterprise carries on business in the other Contracting State through a permanent establishment situated therein. If the enterprise carries on business as aforesaid, the profits that are attributable to the permanent establishment in accordance with the provisions of paragraph 2 may be taxed in that other State.
2. For the purposes of this Article and Article 22, the profits that are attributable in each Contracting State to the permanent establishment referred to in paragraph 1 are the profits it



might be expected to make, in particular in its dealings with other parts of the enterprise, if it were a separate and independent enterprise engaged in the same or similar activities under the same or similar conditions, taking into account the functions performed, assets used and risks assumed by the enterprise through the permanent establishment and through the other parts of the enterprise.

